



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201602212/8

Tiranë ___/___/2017

Lënda : *Rekomandim për zgjidhjen konform akteve normative në fuqi të rasteve të bllokimit të armëve të gjahut shtetasve të cilët i mbajnë ato me leje të organit kompetentit.*

Drejtuar : **Drejtorit të Policisë së Shtetit**
Z. Haki ÇAKO

Tiranë

I nderuar zoti Çako,

Kohët e fundit në institucionin e Avokatit të Popullit kanë ardhur disa ankesa nga shtetas të cilët ankohen ndaj organeve vendore të Policisë së Shtetit për bllokimin e armëve të gjahut, të cilat i disponojnë me lejen e organeve të policisë. Nëpërmjet këtyre ankesave qytetarët pretendojnë se, bllokimi i armëve të gjahut iu janë bërë në kundërshtim me ligjin, pa patur ndonjë shkak ligjor, si dhe nuk janë mbajtur apo dhënë procesverbalet e bllokimit nga punonjësit e policisë që kanë kryer veprimet përkatëse. Gjithashtu ankuesit pretendojnë se bllokimi i armëve të gjahut është bërë për një kohë të gjatë dhe megjithëse kanë bërë kërkesa të vazhdueshme për kthimin e tyre ato nuk u janë dhënë.

Nga verifikimi i këtyre ankesave dhe nga përgjigjet që na kanë ardhur nga organet vendore të Policisë së Shtetit, në disa raste, si në Rrëshen, Librazhd dhe Fier kemi konstatuar se:

Shkaku i bllokimit të armëve të gjahut në këto raste ka qënë i ligjshëm për arsye të konflikteve që disponuesit e tyre kanë patur me persona të tjerë banorë të zonës ku banojnë, si të dyshuar si autor të veprave të ndryshme penale, apo për kryerje të veprës penale të kanosjes, për të cilat materialet procedurale i janë referuar organeve të prokurorisë. Bllokimi i armëve është bërë me qëllim për parandalimin e ndonjë krimi të mundshëm më të rëndë.

Bllokimi i armëve të gjahut ankuesve është bërë për një kohë relativisht të gjatë deri më shumë se dy vjet.

Nga punonjësit e policisë që kanë kryer veprimet përkatëse nuk janë mbajtur apo nuk u janë dhënë procesverbalet e bllokimit të armëve të gjahut pronarëve të tyre.

Nga shqyrtimi dhe hetimi administrativ i këtyre ankesave në rastet e cituara më sipër kemi konstatuar se:

Mbajtja në gjëndje bllokimi i këtyre armëve të gjahut për një kohë relativisht të gjatë që shkon edhe me vite është veprim i kundërligjshëm dhe vjen në kundërshtim me nenin 121/3 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, sipas të cilit afati maksimal i bllokimit të sendeve është 30 ditë. Ndërkohë ju bëjmë me dije se, bllokimi i armës së gjahut për një kohë kaq të gjatë, sikurse ka ndodhur në këtë rast, nuk parashikohet as në dispozitat e ligjit nr. 74/2014 “Për armët”, si dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatimin të dy ligjeve të cituara më sipër.

Ky veprim i policisë ka sjellë shkeljen e të drejtës ligjore të ankuesve për të disponuar, poseduar e gëzuar lirisht pronën e tyre të ligjshme (armët e gjahut) të garantuar nga dispozitat e Kodit Civil.

Gjithashtu mosmbajtja apo mosdhënia e procesverbaleve të bllokimit të armëve ankuesve nga punonjësit e policisë që kanë kryer veprimet përkatëse vjen në kundërshtim me nenin 121/2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Nëse poseduesit e ligjshëm të këtyre armëve kanë shkelur kriteret ligjore për mbajtjen e armës së gjahut, nga komisioni përkatës duhet të veprohet konform dispozitave ligjore në fuqi, duke ia hequr atyre lejen e dhënë për të mbajtur armën e gjahut dhe bërë shitjen e kësaj arme duke zbatuar procedurat përkatëse.

Mirëpo në asnjërin prej rasteve të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit nuk ishte kryer ky veprim ligjor.

Në përfundim të shqyrtimit të rasteve të trajtuara nga ana jonë i kemi bërë rekomandime organeve vendore të Policisë së Shtetit për marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen përfundimtare dhe konform dispozitave të akteve normative në fuqi të problemit të bllokimit të armëve të gjahut.

Në dy raste, në Rrëshen dhe në Librazhd, rekomandimet tona janë pranuar nga Drejtoritë Vendore të Policisë, duke ua hequr ankuesve lejen e dhënë për të mbajtur armën e gjahut dhe bërë shitjen e armëve konform procedurave përkatëse ligjore.

Ndërsa në një rast tjetër në Fier, i cili lidhet me shtetasin K.G. me banim në fshatin Lalar, të cilit i është bllokuar arma e gjahut më datën 27.03.2015, nuk është pranuar rekomandimi ynë me justifikimin e pabazuar, se ai është ende në konflikt dhe në proces gjyqësor.

Për sa më sipër, me qëllim parandalimin e shkeljeve ligjore në të ardhmen dhe për të unifikuar praktikën e organeve vendore të Policisë së Shtetit në të tilla raste, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në gjurmën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen përfundimtare dhe konform dispozitave të akteve normative në fuqi të rasteve të bllokimit të armëve të gjahut në pronësi të shtetasve që i disponojnë ato me leje nëpërmjet një akti administrativ të nxjerrë nga ana juaj me cilësinë e titullarit të Policisë së Shtetit.

2. Zbatimin me korrektesë nga punonjësit e Policisë së Shtetit të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga neni 121 i ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, lidhur me rastet dhe afatet kohore të bllokimit të sendeve qytetarëve të ndryshëm, si dhe për hartimin e procesverbalit të bllokimit të sendeve dhe dhënien e kopjes poseduesve të tyre.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI